

VENDIM
Nr. 690, datë 6.12.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 181, DATË 30.3.2022, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE
NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESTA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË,
DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUIJË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/1, të vendimit nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, në masën 1 994 584 758 (një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe u transferohet bashkive Durrës, Lezhë dhe Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) për Bashkinë Durrës, në masën 1 490 187 768 (një miliard e katërqind e nëntëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

b) për Bashkinë Lezhë, në masën 107 654 732 (njëqind e shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH;

c) për Bashkinë Krujë, në masën 396 742 258 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Durrës, Bashkia Lezhë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku